

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME  
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

24/06/2024

Nr. i Protokollit: 02/ 630

## Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Petrovë

E enjte, më 14 qershor 2024

Kohëzgjatja e takimit: 18:30 – 19:40

Vendi i takimit: SHF “Bajram Curri”

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori për Buxhet dhe Financa – Besnik Ahmeti, Drejtori i drejtorisë për Planifikim Urban Kadastër dhe Gjeodezi – Grejtalb Emini, Asambleistët – Besnik Seferi, Asllan Beqaj dhe Sanie Sadiku.

Rendi i ditës:

### 1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

**Kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi** : Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit që sot ju keni përgjigjë ftesës që të jeni në këtë takim. Ju e dini që në muajin qershor ne si qeverisje vazhdojmë me dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027, kjo mbahet çdo vit, që ne t'i marrim kërkesat e qytetarëve që ti vendosim në buxhet.

Korniza Afatmesme Buxhetore, fazën e parë në kuvend si informat e ka kaluar ndërsa tani jemi në fazën e dëgjimeve publike, ne ishim dje në disa fshatra, ndërsa sot jemi në fshatin e tretë dhe kështu do t'i vizitojmë të gjitha fshatrat e komunës sonë, subjektet politike, organizata e kështu më radhë. Diçka e mirë që ja vlen të theksohet është që viti 2025 buxheti do të ketë një rritje prej afro 1 milion euro, në komunën e Shtimes për çdo vit po rrite buxheti, por nuk duhet harruar edhe investimet të cilat po vijnë nga niveli qendror. Investimet kapitale për vitin 2025 parashihet që të jenë afër 2 milion e 700 mij, subvencionet do të jenë 500 mij euro, paga dhe mëditje do të jenë 6 milion euro. Pjesë të tjera të buxhetit shkojnë tek mallrat dhe shërbimet dhe shpenzime komunale. Në fshatin Petrovë edhe në vitin e kaluar kemi marr kërkesa, disa projekte kanë filluar, e disa të tjera janë në procedura dhe të gjitha ato kërkesa të cilat janë bërë prej banorëve po mundohemi bashkarisht që t'i përmbushim. Në bazë të numrit të banorëve Petrova përfiton buxhet më të madh, ku do ta ketë rastin që edhe për vitin 2025 të ketë buxhet më të madh. Ne sot jemi këtu që t'i marrim të gjitha kërkesat e juaja dhe në bazë të kapaciteteve që i kemi t'i bëjmë pjesë të buxhetit.

Kërkesat e banorëve të fshatit :


- Blerim Hyseni: Të asfaltohet një segment i rrugës “Hysenaj”, (50 metra). Gjithashtu edhe “Rruga e kuqe”, ka nevojë të rregullohet pasi që është në gjendje shumë të keqe.
- Jajush Ademaj: Kanalizim nuk kemi tek rruga “Xhemshir Xhemshiri”. Po ashtu pengesat të cilat janë në rrugë duhet të hiqen.  
E kemi prronin ku kemi probleme prej tij pasi që në të shumtën e rasteve futet uji në oborre e deri mbrenda edhe në shtëpi, nëse ka mundësi me gypa ose ndonjë gjë të ndalohet pasi që është shqetësim për ne.
- Albert Hyseni: Në rrugën “Mehdi Korani”, të vendosen një tabelë 7 ton pasi që kemi pengesë të madhe nga kamionët. Tek çeshmja nuk kemi ndriçim
- Afrim Hysenaj: Nuk kemi ndriçim as kanalizim po ashtu më nevoiten dhe dy shtylla për energji elektrike dhe një kablo tek rruga “Avdush Ademaj”
- Lulzim Hysenaj: Të rregullohen trotuari dhe ndriçimi tek “Mehdi Korani”
- Sokol Rexhaj: Te rruga “Lumi”, të bëhet një urë e re pasi që ajo e cila është për momentin nuk është e qëndrueshme.
- Alban Rashiti: Rregullimi i shtratit të proçkës, nëse mund të bëhet me beton ose me gurë. Po ashtu edhe çështja e kanalizimit kam një pyetje, a ka ndonjë projekt të madh sa i përketë kanalizimit të rregullohet në tërë fshatin?  
Në shkollë nuk kemi ujë të pijshëm për nxënësit dhe po ashtu kur pritet të rregullohet shkolla.
- Nexhat Rashiti: Tek Xhamia kemi probleme me mbulojën e Xhamis, a ka mundësi Komuna të na ndihmojë?
- Baki Hysenaj: Kanalizimi të rregullohet në rrugën “Nazim Bakiu”, (250m). Po ashtu i kemi dy dëshmor, nëse ka mundësi të hapet rruga për tek përmendoret e tyre dmth tek dëshmorët “Nazim Bakiu”, dhe “Qamil Osmani” . Po ashtu të vendosen edhe tabelat e dëshmorëve pasi që na i kanë hequr.
- Asllan Beqaj: Rivitalizim në rrugën “Beqa”  
Në rrugën “Isuf Muharremi”, të rregullohet ndriçimi  
Pastrimi i Lumit në fshatin Petrovë  
Rivitalizimi i rrugës “Xhemshir Xhemshiri”  
Kanalizimi në rrugën “Xhemshir Xhemshiri”  
Rrugën “Haqif Hysenaj”, dhe rrugën “Avdush Ademaj” të rregullohen kanalet atmosferike  
Kanal atmosferik të rregullohet në lagjen Rashiti  
Të rregullohet një park i vogël në Lagjen Ademaj

Procesmbajtës,  
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në Petrovë

Date: 14/06/2024

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	NEXHAT RASHIDI	
2	MAHIR SHADEMAJ	
3	SOKOL REXHAT	
4	BLERIA HYSENAJ	
5	Shaban Bega	
6	Muhamet Qeriqi OSH D+	
7	Albert Hysenij	
8	AGJON Hysenij	
9	Fazli Hysenij	
10	Zulzim Hysenaj	
11	<del>Alvim</del> Jhysenaj	
12	Alban Rashiti	
13	ZULCIM BEQAJ	
14	BOKI ROSHIT	
15	KARL PROKIC	
16	RAIF RAJHITI	
17	Perparim Hysenaj	